



Datë/a:	10.09.2020
Referencë:	05 nr. 070/01-161080/20 dt. 08.09.2020
Për/Za/To:	Lulzim Latifi Rr. "Shaqir Igrishita" nr. 191, Hyrja 1, 10000, Prishtinë
Nga/Od/From:	Arbër Hamidi, zyrtar, Drejtoria e Urbanizmit
CC:	- Mimoza Berisha Prestreshi, u.d. Udhëheqëse e Sektorit të Urbanizmit, Drejtoria e Urbanizmit; - Ardian Olluri, Drejtor, Drejtoria e Urbanizmit
Tema/Subjekat/Subject:	Informim

Lulzim Latifi nga Prishtina, me shkresën 05-070/01-161080/20 dt. 08.09.2020, i ka dorzuar Drejtorisë së Urbanizmit ankesën kundër njoftimit publik nr. 05-350/02-147459/20 të dt. 26.08.2020 deri me 09.09.2020 të kërkesës 05-350/02-147459/20 dt. 20.08.2020 për caktimin e kushteve ndërtimore, me të cilën njoftohet Drejtoria e Urbanizmit se ankuesi ka kontest gjyqësor me kërkuuesin, në lidhje me parcelën kadastrale për të cilën janë kërkuar kushtet ndërtimore.

Ky Organ, përmes procesverbalit 05-350/02-147459/20 dt. 10.09.2020, ka pranuar dokumentacionin si në vijim: "Aktgjykim" C. nr. 1247/16 dt. 18.06.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas të cilës refuzohet e pabazuar kërkesëpadia e paditësve me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se paditësit janë bashkëpronarë në parcelën kadastrale 668-0 dhe 669-1; "Aktgjykim" Ac. nr. 4949/19 dt. 10.04.2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, sipas të cilës refuzohet ankesa e paditësve, ndërsa vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C. nr. 1247/16 dt. 18.06.2019; "Aktvendim" C. nr. 1247/16 dt. 29.06.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas të cilës shfuqizohet masa e sigurimit të kërkesëpadisë e caktuar me Aktvendimin e gjykatës së Apelit Ac. nr. 4216/17 dt. 20.10.2017.

Drejtoria e Urbanizmit, pas shqyrtimit të ankesës 05-070-01-161080/20 dt. 08.09.2020 dhe përmbajtjes së saj, bazuar në dokumentacionin e sipër përmendur dhe shqyrtimit të saj, si dhe pas vërtetimit në regjistrin kadastral, ju informon se, parcelat kadastrale për të cilat me kërkesën 05-350/02-147459/20 dt. 20.08.2020 janë kërkuar kushtet ndërtimore, gjegjësisht 668-0, 669-1 dhe 669-2 ZK. Matëçan, nuk kanë masë të përkohshme, andaj, nuk kemi bazë për ndërprerjen e procedurës për caktimin e kushteve ndërtimore.

Kjo shkresë u përpilua në 4 (katër) kopje identike dhe i dorëzohet: Ankuesit; kësaj Drejtorie; në dosje të lëndës 05-070/01-161086/20 dt. 08.09.2020; si dhe në dosje të lëndës 05-350/02-147459/20 dt. 20.08.2020.